

**PHILOLOGY AND PHILOLOGISM IN THE ALBANIAN AREA OF  
MACEDONIA**  
**FILOLOGJIA DHE FILOLOGJIZMI NË HAPËSIRËN SHQIPTARE TË  
MAQEDONISË**

**Imer ALILI<sup>1</sup>**

<sup>1</sup> *Department of Italian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova*

<sup>\*</sup> *Corresponding author e-mail: imer.alili@unite.edu.mk*

---

**Abstract**

Considering the fact that the discipline which "technically educates the critical disposition of man and that it is nothing but criticism [...], and that only in philology criticism is exercised in its entirety, and that the aim of philology is history", each historian must also be a philologist (Friedrich Schlegel), and such must be, first of all, anyone who deals with those particular 'historical' facts, of those fundamental evidences of civilization which are artistic and literary productions; thus, to make the verification of the truth and the correct understanding of the texts and documents without detaching from the scientific rigor. Schlegel also claimed that even just reading is "clearly a philological act" (ibid.).

For what, the totality of studies that moving across different sectors and relying on different research instruments, but always based on a critical observation of texts, documents and evidence, aiming at an accurate and detailed understanding of the text itself in a precise historical-cultural setting and even to present the integral knowledge and the reconstruction of a historical period or of one or more civilizations by studying the language, literature and various cultural manifestations.

Furthermore, the philologist should engage in more detailed traces, e.g., in the critical analysis of a position, where there is an essayistic doubt about a particular verse, makes the identification of a source, the sharpest and most functional research identification of a punctuation mark, verification of a chronological record, etc. Such a philological study and quite valuable and detailed in connection, for example, with the issue of putting in the case of gender at the beginning of the poetic verse has been done by the worthy teacher and excellent connoisseur of Albanian language and literature, Arbëresh Zep Gradilone (it. Giuseppe Gradilone).

In his volume "La letteratura albanese e il mondo classico" (Quattro studi) (Albanian literature and the classical world, Four studies), Bulzoni editor, 1983 Rome, in which he develops valuable scientific studies and linguistic evaluations of some great protagonists of Albanian language and literature, such as Jeronim De Rada, Zef Skiroi, Gjergj Fishta, that is, of the era of the revival of Romanticism in Europe. We will not go into the merit and evaluation of the work quite meticulous for the categorization that the Author makes there in relation to his critical view of the works of the authors in question, but of course we will emphasize his view of the grammatical aspect or more precisely of that syntactic one which has placed in its volume. However, it seems like a novelty and therefore an impetus to look at from this aspect the literature produced and quite enriched already and in particular the Albanian language used in the Pan-Albanian literary treasury.

**Keywords:** *philology, philology, text criticism, critical publishing, syntaxes.*

---

---

## Përmbledhje

Duke pasur parasysh faktin se disiplina e cila “edukon teknikisht dispozicionin kritik të njeriut dhe se ajo nuk është tjetër pos që kritikë [...], dhe që vetëm në filologji kritika ushtrohet në tërësinë e saj, e që synimi i filologjisë është historia”<sup>43</sup>, çdo historian duhet të jetë edhe një filolog (Friedrich Schlegel), dhe i tillë duhet të jetë, para së gjithash, secili që merret me ato fakte të veçanta ‘historike’, të atyre dëshmime themelore të civilizimit që janë prodhime artistike dhe letrare; pra, të bëjë verifikimin e së vërtetës dhe të të kuptuarit të drejtë të teksteve dhe dokumenteve pa u shkëputur nga rigoziteti shkencor. Po ashtu edhe Schlegel pohonte se edhe vetëm të lexosh është “qartazi një akt filologjik”. (Po aty).

Për çka, tërësia e studimeve që duke lëvizur nëpër sektorë të ndryshëm dhe duke u mbështetur në instrumente të ndryshme hulumtimesh, por që bazohen gjithnjë në një vëzhgim kritik të teksteve, dokumenteve dhe dëshmime, duke synuar drejt një të kuptuarit të saktë dhe të hollësishëm të vetë tekstit në një vendosje të saktë historiko-kulturore e bile, edhe të parashtrojë njohurinë integrale dhe rikonstruimin e një periudhe historike apo të një a më shumë civilizimesh duke e studiuar gjuhën, letërsinë dhe manifestimet e ndryshme kulturore.

Më tej, *filologu* duhet të angazhohet në gjurmimet më të hollësishme, p.sh., në analizimin kritik të një poezie, ku ka një dyshim esejetik lidhur me ndonjë varg të caktuar, bën identifikimin e një burimi, hulumtimin më të mprehtë dhe më funksional të identifikimit të një shenje pikësimi, verifikimin e një të dhëne kronologjike, etj. Një studim filologjik të këtillë dhe mjaft të vlefshëm e të hollësishëm në lidhje, p. sh., me çështjen e vënies në rasën e gjinore në fillim të vargut poetik e ka kryer mësuesi i denjë dhe njohësi i shkëlqyeshëm i gjuhës dhe i letërsisë shqiptare, arbëreshi Zep Gradilone (it. Giuseppe Gradilone).

Në vëllimin e tij “La letteratura albanese e il mondo classico” (Quattro studi) (Letërsia shqiptare dhe bota klasike, Katër studime), Bulzoni editore, 1983 Romë<sup>44</sup>, në të cilin zhvillon studime dhe vlerësime të vyeshme shkencore e gjuhësore të disa protagonistëve të mëdhenj të gjuhës dhe letërsisë shqipe, si Jeronim De Rada, Zef Skiroi, Gjergj Fishta, pra, të epokës së ngjalljes së romantizmit në Europë. Ne nuk do të hyjmë në meritën dhe në vlerësimin e punës mjaft të përpiktë për kategorizimin që autori aty bën në lidhje me vështrimin e tij kritik ndaj veprave të autorëve në fjalë, por, sigurisht do ta vëmë theksin në vështrimin e tij të aspektit gramatikor apo më saktësisht të atij sintaksor që e ka plasuar në vëllimin e tij. Gjithsesi, duket si një risi prandaj edhe një shtytje që të vështrohet edhe nga ky aspekt letërsia e prodhuar dhe mjaft e pasuruar tanimë dhe në veçanti gjuha shqipe e përdorur në thesarin letrar mbarëshqiptar.

**Fjalët kyçe:** *filologjia, filologjizmi, kritikë teksti, botim kritik, sintaksë.*

---

Në fillim të këtij punimi do të ndalemi pak për ta trajtuar, apo për t’i përkthyer ca paragrafë me përmbajtje profesionale dhe udhëzuese që kanë të bëjnë me filologjinë si disiplinë<sup>45</sup> dhe si shkencë në vete. Filologjia nuk është vetëm një term gjenerik me të cilin nënkuptohet vetëm Fakulteti Filologjik, por është një lëmë serioze por edhe tërheqëse dhe ka një lloj ‘dekalogu’ të vetin që duhet njohur dhe ndjekur. Ndoshta, këtu përzihet apo edhe shkrihet me lëndën që këtu thuhet shkrim akademik, por, sigurisht nuk e përmban atë karakterin autentik që kjo lëndë e ka nëpër universitetet evropiane.

Këtu, jemi munduar që t’i mbartim ca udhëzime, që besojmë se do të jenë të nevojshme e të dobishme për nivelin akademik të studentëve dhe jo vetëm dhe me qëllim ngritjen e kulturës

---

<sup>43</sup> FORTINO COSTANTE I. *Definizioni preliminari e cenni di storia della filologia*, (Material didaktik, i parashikuar dhe shpërndarë studentëve për lëndën e Filologjisë shqipe në Universitetin La Sapienza, Romë 1998-1999, në Institutin e Albanologjisë atje). Pra, janë shënime dhe definicione që unë i kam mbledhur gjatë atyre ligjëratave për këtë materie studimesh atje.

<sup>44</sup> GRADILONE GIUSEPPE, *La letteratura albanese e il mondo classico* (Quattro studi), Bulzoni editore, Roma 1983, ff.149-176.

<sup>45</sup> Shih shënimin 1. Në këtë punim, është synuar vetëm të plasohet materiali në fjalë, jo për të thënë apo pretenduar që këto mësimet i kemi prodhuar vetë, nga gjenialiteti ynë. Por, kemi vërejtëur që ky lloj studimesh të specializuara në hapësirat tona është paksa më i ndryshëm, se ai në Universitetet perëndimore apo, ndofta, edhe mungon tërësisht. Prandaj edhe e kemi konsideruar si një risi të nevojshme.

akademike dhe të profesionalizimit të punës shkencore në nivelin e atyre të mirëfillta akademike dhe protagoniste evropiane të kohës në të cilën jetojmë.

Prandaj, në vijim le të shohim se me çfarë merret në thelb *Filologjia*.

## **Kritika e tekstit**

Çasti primar i çdo studimi filologjik është kujdesi ndaj tekstit. Filologjia tenton të ribëjë, në tërësinë e vet dhe në trajtën e vet më autentike tekstin që e ka si objekt studimi, duke bërë çdo përpjekje për t'i shlyer gabimet, keqkuptimet dhe deformimet arbitrare që, gjatë kalimit të kohës dhe për shkaqe nga më të ndryshmet, mund të jenë futur në emër të dikujt tjetër dhe vijimisht edhe duke patur të njëjtat edhe një difuzion dhe fat pak a shumë të suksesshëm.

Në rastet kur dëshmitë e një teksti janë të pamjaftueshme, nuk mund të flitet për filologji *tout court*, por flitet për një 'filologji tekstuale' apo më mirë të thuhet për 'kritikë teksti'. Prandaj, për praktikë didaktike supozohet se studimi i një vepre letrare mund të bëhet, duke vijuar në mënyrë të rregulluar, përmes tri fazash si në vijim:

- a) Konstituimi i tekstit;
- b) Egzegjeza e tij (apo interpretimi kritik i një teksti apo i një pjese të tij), dhe
- c) Analiza kritike, nga një pikëpamje estetike, kulturore, ideologjike, etj.

Sidoqoftë, filologu i vërtetë e di se mund të bjerë në gabime të keqkuptimit dhe 'falsifikimit' të një vepre të caktuar, prandaj, mundohet ta shmangë një gjë të tillë sa më shumë të jetë e mundur. Në një tekst antik, p.sh., ku mungojnë shenjat e pikësimit, përpiluesi apo filologu, duhet ta bëjë të lexueshme veprën për lexuesin modern, prandaj është e obligueshme t'i fuët shenjat e pikësimit që, vetvetiu, do të thotë interpretim. Por edhe më tepër, pra, ai implikohet jo vetëm në sensin letrar, por edhe në stilin. Filologu duhet ta kuptojë në mënyrë të përkryer mendimin dhe qëllimet e dokumentit të studiuar, kulturën e autorit, psikologjinë e tij, periudhën së cilës i ka takuar.

Për sa i takon aktivitetit të filologëve, një studiues i famshëm italian, Ettore Romagnoli citon: "Çdokush që e kupton mendimin dhe e ndjen sentimentin e një autori, secilën herë kur mungon kuptimi dhe nuk qëndron mirë, është i shtyrë nga një impuls i parëzistueshëm që ta përmbushë apo ta korrigjojë me të tijën". Nëse filologu ka punuar me vetëdije dhe me kompetencën e duhur, konstituimi i një teksti përmban në mënyrë implicite interpretimin e vet dhe vlerësimin kritik; por, siç është e njohur, ka edhe publikues që mund të numërohen.

## **Tekst origjinal, kopje, tradita**

Teksti *origjinal* i kuptuar materialisht, mund të jetë i shkruar nga autori (*autograf*) apo nën mbikëqyrjen e tij (*idiograf*), apo edhe mund të jetë një botim i shtypur i aprovuar. Nga origjinali rrjedhin *kopje* (kopja e parë quhet *apograf*, e dyta *antigraf*, pastaj vijnë *ekzemplarët*). Kur origjinali është humbur dhe vepra është ruajtur nga një apo më tepër kopje, në dorëshkrim apo i shtypur, këto thuhet *testimoni* (*dëshmi*), sepse ofrojnë njëfarë dëshmie për tekstin e prodhuar nga autori; dhe në tërësinë e tyre dëshmitë përbëjnë *traditën*, sepse, janë mjetet që e kanë ruajtur dhe përcjellë deri tek ne. Tradita, shpesh vlen si një shtrirje e shkruar së cilës nuk i takon kualifikimi i origjinalit, që megjithatë është pikë referimi e nevojshme për t'u orientuar ndërmjet kopjesh shpesh të adaptuara në mënyrë të lirshme për egzigenca didaktike dhe për edifikime të posaçme.

*Tradita direkte* është vetë vepra si e tillë, ndërsa *tradita indirekte* përbëhet nga përkthime eventuale apo nga citate përbrenda një vepre tjetër; vepra e Dantes "*De vulgari eloquentia*" është një vepër e dëshmise të ndryshme, p.sh., është përkthimi i saj në italisht nga Trissino në vitin 1529.

Një dorëshkrim si i tillë na jep dëshmi të drejtëpërdrejta por edhe të tërthorta bashkërisht, duke e parë pavarësinë e citateve të tilla, që shpesh rrjedhin nga një dëshmi jo e ruajtur. Për çështje të veçanta, një dëshmi e vetme (edhe një original) mund të rezultojë e përbërë nga pjesë të ndara dhe ca herë edhe të ndryshme nëpër biblioteka të ndryshme.

“Original dorëshkrim” dhe “autograf” nuk janë sinonime: ekzistojnë, meqë rallë, raste të një autografi që nuk është origjinali, në qoftë se autori të ketë kopjuar veprën e tij, ashtu si p.sh., bëri Manzoni në vitin 1857 me pjesë të “*Pentecosta-s*” që i hoqi nga versioni i tij final. Karshi origjinalit të humbur, në filologjinë klasike p.sh., punohet me kopje të cilat, krahasuar me kohën e autorit, janë të mëpastajme, në pak raste me fat, për ca shekuj, shpesh edhe për një mijë vite.

Është një e dhënë historike, se ecuritë që duhen ndjekur përpara një *tradite* (dëshmie) të bërë vetëm nga kopjet kanë qenë të elaboruara, në skeletin e tyre thelbësor, aty ku situata e tillë ishte rregull, pra në kontaktet me autorët grekë e latinë, me Dhjatën e Vjetër dhe të Re, etj. Kah mesi i shekullit të tetëmbëdhjetë ka marrë hov e ashtuquajtura metoda e Lachmann-it, që është ai i cili diti ta organizojë në mënyrë sistematike dhe ta aplikonte me rigorozitet një tërësi pjesësh të nocioneve paraekzistuese.

## Manuskriptet (Dorëshkrimet)

Deri në shpikjen e shtypit, dëshmitë janë të përbëra nga dorëshkrimet, (*handschriftenkunde*) që njihen me emrin *codicologia*. Këto dëshmi janë dokumente apo raperte arkeologjike, që nëse përdoren në mënyrë të duhur mund të jenë përplotë me lajme dhe të na japin të dhëna të çmueshme për kulturën e qarqeve dhe ambienteve të caktuara. Dorëshkrim është secili dokument i shkruar me dorë mbi një çfarëdo material (papyrus, dërrasë balte, pergamenë, letër) që bënte të mundur të shkruhej në një mënyrë të shpejtë (*shënime dhe epigrafe*), por, nuk janë manuskripte gravurat në drunj, gurë, etj.

Në lashtësi shkruhej kryesisht në papiruse të rotulluara (*volumen*), pastaj u kalua në pergamenën e shtrenjtë, dhe vetëm në shekullin I pas erës sonë dorëshkrimi merr trajtën e librit të sotëm, pra, të më shumë tabelave të lidhura me njëra-tjetrën dhe që u quajt *codex* (libër kompakt). Në fund të shekullit XII arabët e futën në Evropë letrën (të shpikur nga kinezët), dhe ky material i ri, më pak rezistent, por shumë më i lirë u bë definitivisht si material për të shkruar. Pastaj, natyrisht, u vijua me *ekzemplare*, shkresa etj.

Fatkeqësisht, në pjesën më të madhe të rasteve *filologët* më me përvojë dhe më specialistët e paleografisë dhe të kodikologjisë mund të posedojnë dhe me vështirësi vetëm një pjesë të pakët të informacioneve të sigurta, pra, të teksteve origjinale, prandaj janë të detyruar të ekzemplojnë dhe transkriptojnë apo t’i “interpretuojnë” tekstet duke i formuluar dhe riformuluar ato. Puna e tyre bëhet kështu më e vështirë dhe më e rrezikshme sa që t’i falsifikojnë dhe t’i devijojnë origjinalet, për t’u vendosur një datë të përafërt: prandaj, në mënyrë të pashmangshme shkohet drejt një *editio variorum* (botimi të ndryshuar)...

Për këtë, është tepër e vështirë të ndreqet një *restitutio textus* (rikthim i tekstit). Varësisht nga rastet, një *codex* do të definohej: *miscellaneo* (mishelaneo) që janë tekste heterogjene; *i perzier* (materiale të ndryshme); *kompozit* (më shumë kodekse të lidhura bashkë); *adespot* (nëse është pa emrin e autorit); *anepigraf* (nëse është pa titull); *palinsest* (nëse së pari është grydhur dhe pastaj është shkruar mbi të); *opistograf* (nëse në atë që është fshi për shkak të ‘vjetërsisë’ shkruhet mbi të diçka tjetër); *acefal* (kur mungojnë një apo më tepër faqe në fillim). *Mutilo* (nëse i mungojnë një a më shumë faqe të dokumentit në tërësi). Për të arritur një përshkrim të thuktë dhe të saktë të një dorëshkrimi duhet mbajtur parasysh që: në një dorëshkrim, siç u pa, asnjë imtësi nuk është pa

domethënie dhe nuk do të mund që të lëret anash. Por, janë të ndryshme pikëpamjet dhe interesimet e atyre që i marrin në shqyrtim: historiani, “tregtari”, etj., por, specialistët e kodikologjisë dhe të paleografisë i shqyrtojnë mbi të gjitha kualitetin e prejardhjes së materialit, elegancën dhe rregullshmërinë e shkrimit, etj.

Ndërkaq, një filologut i intereson, jo aq aspekti i jashtëm i dokumentit por *vlera ekdotike* që asaj dëshmie të vetme mund t’i atribuohet gjatë shqyrtimit që: një dorëshkrim nuk është, siç e dimë, një replikë e pastër dhe e thjeshtë apo një kopje mekanike e një teksti; por është, nga njëra anë, një dokument i pasur me histori që do duhet të rindreqet saktësisht edhe me ndihmën e çdo të dhëne edhe më të imët, për të mund të finalizohet ajo që thuhet *restitutio textus* (rikthimin e tekstit) që: çdo kopje, së paku nëse teksti arrin një vëllim të caktuar, përmban një numër të caktuar gabimesh, d.m.th., të inovacioneve karshi origjinalit, dhe kështu dorëshkrimin do ta karakterizojnë numri, origjina dhe natyra e gabimeve të pranishme.

Më tej, pas një sërë verifikimesh, duhet bërë edhe verifikimi i prejardhjes së kopjesit dhe i hapësirës gjuhësore, ku kopjet janë transkriptuar. Por, duhet edhe të nënvizohet se aty ku emri dhe prejardhja e kopjesit nuk dëftohen në vetë kodeksin, do të duhet prapëseprapë t’i besojmë shtjellimit të brendshëm – një hulumtim i tillë del të jetë mjaft i vështirë...

## Shtypi

Edhe këtu ka të bëhet me kopjet, për të cilat, botuesit, tipografët dhe revizorët e skicave i zëvendësojnë *amanuense*-t (dëshmitë e parashtypit) që shpesh dhe pashmangësisht sjellin deri te fenomenologjia e gabimeve dhe konfigurohen si *manipulime të pamerituara* shumëllojshmërisht të motivuara, si gabime ‘kritike’ apo si *mende volontarie*. Transkriptimi që i atribuohet një dorëshkrimi, në fakt, është një çështje thelbësisht private, ndërkaq një tirazh shtypi në shumë kopje nuk mund të jetë tjetër pos një fakt publik; prandaj mësimin që ajo pastaj përhap ka një rrezatim më të gjërë dhe mund t’i japë vend, me pasoja lehtësisht të imagjinueshme, një *vulgate* të vërtetë që shpesh pastaj bëhet shumë e vështirë që të vëhet në diskutim.

Në të njëjtën kohë, dhe gjithnjë për karakterin ‘publik’ që kanë, mund të ngjajë që të ndikojnë interesa dhe kushtëzime të llojllojshme; prerje dhe prekje të sasive të ndryshme, munden p.sh., të imponohen apo këshillohen nga censura, apo edhe të futen për qëllime ideologjike personale, propagandistike, fetare, etj. *Privilegji* që iu është dhënë botuesëve mund ta shtyjë atë që ta botojë veprën me të dhëna tipografike të rrejshme, ta heshtë tërësisht, apo edhe të procedojë me manipulime tjera.

## Nga dorëshkrimi deri te shtypi

Në fillim, libri i shtypur, nuk e ka zëvendësuar dorëshkrimin, por e ka përkrahur atë. *Incunaboli* (lat. fëmijëria, fillimi, origjina), janë të gjithë librat e publikuara deri në vitin 1500. Në Itali shtypi kishte depërtuar pak pas vitit 1460 në Subiaco. Prej atëherë e këtej, shkronjat e shtypit dalëngadalë modifikoheshin. Në Itali ekzistonte edhe shtypi popullor, i cekët për nga kualiteti dhe kuantiteti, jetë shënjtish, karnevalesh e pagëzimesh dhe jo me më shumë se dhjetë fleta të vëna bashkë e të njohura si *dorëshkrime strajcash*.

Nga pikëpamja e filologut botues është mirë të mbahen parasysh dy konsiderime të përgjithshme: duke pasur të bëhet me dorëshkrime dhe me shtypin e të njëjtës vepër, nuk është e thënë që shtypjet të jenë më pak të rëndësishme vetëm sepse si zakonisht janë më të reja; por, të cilat, si *editiones principes* (botime të para) riprodhojnë shpeshherë dorëshkrime antike që janë

humbur, dhe për këtë janë shumë të vlefshme. Sidoqoftë, shtohet se duhet të studiohen imtësisht më të vogla jo vetëm të dorëshkrimeve, por edhe ato të shtypurat, mbi të gjitha ato të vjetrat, duke mbajtur parasysh që ekzistojnë dallime të shkaktuara nga aksione të vetëdijshme apo të pavetëdijshme të tipografëve gjatë shtypjes së secilës fletë, dhe dallimeve që kanë të bëjnë kryesisht me ballinën dhe me heqjen, shtimin apo ndërrimin e një pjese jo të madhe të materialit etj., që i lypen përgjegjësit të botimit për funksionimin e shitjes së suksesshme.

Duke bërë botime “të reja”, botuesit shpesh bëjnë ballina “të reja”, që kështu mbartin ndryshime ose shtrembërime. Këto gjeste ndryshimesh mund të jenë të rastësishme, por mund të jenë edhe të qëllimshme, të futura gjatë fazave të shtypit. Pastaj, për t’ia dalë ta hetosh dallimin ndërmjet atyre librave të shtypur të ndryshuar, nga pikëpamja logjike natyrisht duket një punë mjaft e vështirë. Prandaj, është një egzigjencë e pashmangshme që botimi kritik i një teksti të shtypur të mos kufizohet në riprodhimin e një ekzemplari çfarëdo, por të jetë i paraprirë nga një hulumtim që do të vërtetonte nëse ekzemplarët e ndryshëm janë ose jo të dallueshëm mes tyre. Sidoqoftë, tekstet e shtypura si dorëshkrimet, i lehtësojnë disa faza të hulumtimit.

## **Gabimet dhe variantet**

Të shkruarit me dorë i nënshtrohet formave të llojllojshme të mospërkryerjes, ashtu sikurse secili mund ta provojë vetë; në fakt, edhe duke komponuar një origjinal, ngjan që të gabohet, por rreziku është edhe më i madh nëse kopjohet dhe mbi të gjitha nëse teksti është i gjatë, prandaj prodhon huti dhe lodhje. Ndër inovacionet e ndryshme të mundshme, disa prej tyre janë të dukshme vetvetiu, pra kanë karakteristika manifestuese të gabimeve; ca të tjera janë *subdole* (të qëllimshme) sepse janë të pajisura me kuptime, qëndrojnë mirë në kontekstin, pra, kanë një pamje autenticiteti që vetëm krahasimi dhe divergjenca karshi dëshmive të tjera do të mund ta vinte në dyshim apo edhe ta çmaskojë.

P.sh., ca dorëshkrime të *Komedisë* e paraqesin kështu: “e durerà quanto *l’moto* lontana” (dhe do të zgjasë sa lëvizja në kohë), ndërsa do tjerë “e durerà quanto *l’mondo* lontana” (dhe do të zgjasë sa bota larg), për çka, nuk është vetvetiu e qartë se cili është gabimi, prandaj këtu flitet për *varianta*. Variantat mund të jenë neutrale, indiferente, ekuivalente. Edhe kualiteti i kopjes mund të çojë në gabime. Keqkuptimi *optik* të cilit i shtohet edhe komponenta psikologjike; p.sh., lexohen shpesh vetëm katër shkronjat e para në mënyrë të kujdesshme dhe pjesa tjetër e fjalës vetëm shikohet duke menduar se ia qëllojmë, dhe kjo thuhet *lexim sintetik* që, vijimisht mbart gabime.

Një lloj tjetër i shpeshtë i gabimeve i lidhur me mekanizmin e lexim-transkriptimit është ai si pasojë i *homeoteleutologjisë* të tipografëve, të vetëm ca pjesëve, kur, gjatë të shtypurit e shikojnë vetëm fjalën e fundit të *perikopies* (segment i faqes). Fenomene të këtilla hasen edhe duke lexuar libra modernë dhe gazeta, sepse tipografi, nuk është tjetër pos një kopjues i veçantë. Këto gabimet e përmendura, që bëhen nga kopjues në kushte kohore dhe vendore të ndryshme dhe të dallueshme janë të karakterizuara si *poligjenetike*. Përkundrazi, është *monogjenetik* gabimi që, duke u hasur i njëjtë në dy apo më tepër kopje të së njëjtës vepër ka të tilla karakteristika saqë e bën të pagjasë hipotezën që një kopjues ta ketë bërë pavarësisht nga tjetri. Gabimet poligjenetike si të tilla, nuk kanë nevojë për vetëm një burim, ndërsa ato monogjenetike si të tilla janë tepër të dukshme për të menduar që t’i ketë bërë autori.

## **Botimi kritik**

Për botim kritik mund të flitet me legjitimitet të plotë vetëm me kushtet që: 1. Hulumtimet të jenë bërë në bazë të të gjitha dëshmive të gjetura dhe me çdo mjet të dobishëm me qëllim të asaj

që thuhet *restitutio textus* (rikthim, rindreqje e tekstit); 2. Të vihen në dispozicion të lexuesve të gjitha elementet e nevojshme për ta kontrolluar dhe për ta gjykuar punën e botuesit.

Vetë tekstit kritik në fund i lidhet, duke preferuar fusnotat në vend se në shtojcë, atë që thuhet *aparati kritik*, që për çdo log të vetëm do të furnizojë një vizion të rregulluar dhe global të dëshmimeve, duke lejuar që të njihen edhe burime të tjera alternative që botuesi i ka gjykuar si të këqija dhe të papranueshme në mënyrë që të kontrollohen sistematikisht bazat dokumentuese mbi të cilat themelohen parapëlqimet e veçanta. Ndërsa, nuk janë të domosdoshme për të qenë i vlefshëm definicioni i shpallur, ashtu si edhe kontribute tjera që në botimin kritik, mund të përbëjnë një përplotësim të vlefshëm.

### **Kriteret e botimit**

Për konkludim të *prolegomenos* (hyrje e një teksti) që përbëjnë pjesën plotësuese të *botimit kritik*, do të jetë mirë që të tregohen dhe të ritheksohen në mënyrë të shkurtër kriteret në të cilët është përmbajtur për fiksimin dhe prezantimin e vetë tekstit. Paragrafi i tillë përmban udhëzimet në vijim:

- a) Mënyrën e përdorimit të stemës, që zgjedhet si teksti bazë;
- b) Normat e ndjekura në paraqitjen grafike, ndërhyrjet, luhatjet, etj.;
- c) Qartësime në lidhje me përdorimin e shkronjave tipografike të diferencuara me simbole grafike jo të zakonshme;
- ç) Kriteret themelore – grumbullimi i rimave të sigurta me numra romakë, ato të dyshimtat me numra arabë;
- d) Kriteret e ndjekura në ndreqjen e aparatit kritik;
- dh) Lajmërimet preliminare për shtojca eventuale për njohjen e zakonshmërisë gjuhësore të autorit dhe burime tjera.


### **Aparati kritik**

Për secilin botim kritik është i patjetërsueshëm dhe i nevojshëm *aparati kritik*, që ka për qëllim të ofrojë pikë për pikë kornizën e plotë të dëshmimeve të dobishme për atë që thuhet *restitutio textus* (rikthim apo rindreqje e tekstit). Në aparatin kritik duhet të regjistrohen:

- a) Të gjitha leksionet e arketipit që janë konsideruar të gabuara;
- b) Variantat e refuzuara, variantat e një apo më shumë nënarketipeve;
- c) Nënvariantat, pra, “dëshmitë që, pas një degëzimi të mëtejshëm të traditës, shërbejnë për rikonstruim të leksionit të themeluesit ose të nënarketipit”;
- d) “Leksione që pajtohen mes tyre, të më shumë mbartësve të variantave, në rastin kur ato të jenë të hequra anash në favor të leksionit të një tjetër mbartësi të varianteve”;
- e) Lajme të llojit paleografik që konsiderohen të patjetërsueshme për një gjykim më të motivuar për vlerën e një dëshmie të caktuar;
- f) Emrin e botuesit nga i cili është pranuar një supozim i caktuar;
- g) Dyshimet mbi secilin leksion, propozime eventuale alternative.

Ndërkaq, në aparatin kritik, nuk duhet të përfshihen variantat thjesht grafike dhe morfologjike.

## Originali



Në origjinalin duhet të jenë të shfaqura të gjitha leksionet e X-it, pra të  $\alpha$  dhe  $\beta$ . Në rastin e divergjencës ndërmjet dy familjeve ( $\alpha$  e  $\beta$ ), çdo leksion i dëshmuar nga njëri prej dy nënarketipeve  $\alpha$  ose  $\beta$ . Përbrenda njërit nga dy grupet do të mund të verifikohet që C dallon nga A dhe B. Në aso raste, akordimi i A+B mjafton për rikonstruimin e leksionit të  $\alpha$ , ndërsa materiali i ofruar nga C ngelet i izoluar sepse ka të bëhet me *lectio singularis* (leksion i vetmuar) pa vlerë stematike dhe prandaj përjashtohet nga aparati.

Diskursi analog vlen edhe për grupin  $\beta$ , në linjë të të cilit duhet sidoqoftë mbajtur mend se kodi D, i vetëm ka vlerë stematike të barabartë me atë të tri kodekseve që e formojnë nëngrupin b, ndërkaq kodeksi H, duke rezultuar *descriptus* (përshkrues) prandaj edhe nuk ka ndonjë vlerë ekdotike dhe nuk merret në konsideratë. Flitet për aparat negativ kur janë të dëftuara vetëm dëshmitë kyçe të leksioneve divergjente në krahasim me leksionin e pranuar në tekstin kritik, ndërsa, aparati pozitiv është tërësisht eksplisit sepse i tregon edhe dëshmitë e leksionit të pranuar.

### Variantat e autorit

Janë modifikimet që i fut autori në tekstin e një vepre të tij. Në një mënyrë autoritare e ka dëftuar hulumtimin në vendngjarje të varianteve të autorit, para gjysëm shekulli, filologu i madh klasik Giorgio Pasquali, i cili i kishte kritikuar abuzimet që i kishin bërë ata të cilët donin që me çdo kusht të zbulonin varianta autorësh në traditën e teksteve greke dhe latine. Ribërje d.m.th., rishkrim nga ana e një autori tjetër me një qëllim të deklaruar. Ndërsa, futje abuzive, janë interpolacionet, natyra e të cilave shpesh është e pasigurt në mes ribërjes, falsifikimit, glosës eksplikative, etj.

### Botimi diplomatik

Është ai botim kritik i tekstit për një dorëshkrim në të cilin respektohen të gjitha karakteristikat e jashtme të ekzemplarit, sikur shenjat e pikësimit, shkurtesa, përdorimi i shkronjave të mëdhaja dhe të vogla, etj. Fatkeqësisht, lloje të këtilla të botimeve, sot janë të rralla.

### Botimi mekanik

Është botimi i tekstit që i përmbledh të gjitha dëmtimet që i ka, qofshin ato fizionomike, mekanike, etj., pra, botohet mu ashtu si është gjetur, pa ndonjë intervenim në asnjëfarë mënyre.



## Në lidhje me sintagmën në gjinore në poezinë shqipe

Për sa i takon edhe trajtimit, nga ana e profesorit Gradilone, edhe të këtij aspekti të poezisë shqipe, mendoj se duhet trajtuar më thellësisht edhe nga ana e jonë këtu. Duke qenë mjaft kompetent edhe në fushën e filologjisë klasike, profesori Gradilone thekson se: “Hilmi Agani ha già rilevato l’inversione del posto del genitivo determinante, ma soltanto nel Mjeda e nel Gurakuqi, senza fare la ricognizione di tutti i casi, senza svolgere quindi l’argomento né sistematicamente, né diacronicamente, senza infine individuare la causa dell’inversione, come se la nuova forma del sintagma fosse propria (fosse propria)<sup>46</sup> dell’indole della lingua e non dei modelli tenuti, come si è visto, presenti inconsapevolmente (risultato di esperienze letterarie) o consapevolmente (conseguenza di una poetica)”<sup>47</sup>, duke cituar vlerësimet e Aganit për këtë çështje: “Në këtë kuptim, duke folë në formë të përgjithësuar për mundësinë që gjinorja përcaktuese t’i dalë përpara emrit të cilin ajo vetë e përcakton, kishim parasysh edhe mundësitë potenciale të shqipes në këtë pikë. Në anën tjetër Demiraj nuk ka të drejtë, sepse, jo vetëm që një inversion i tillë në poezinë shqipe mund të ndeshet, por kur është i suksesshëm i jep edhe bukuri shprehjes e vargut”<sup>48</sup>.

Pas çka vijon një ‘përmirësim’ i përshtypjes së vet Aganit në lidhje me vëndosjen e sintagmës në fjalë por, “duke mos e gjetur shkakun e vërtetë”<sup>49</sup>: “siç vëren Hilmi Agani, në vjershat e N. Mjedës, të L. Gurakuqit dhe të ndonjë tjetri gjinorja ndeshet edhe e pavendosur. Por do pasur parasysh se në këtë rast kemi të bëjmë me një përdorim të kushtëzuar nga kërkesat e vargut e ndofta edhe me një ndikim të poezisë italiane”<sup>50</sup>. Tani, të thuhet që në gjuhën shqipe apo edhe në poezinë shqipe (aty autori bën fjalë vetëm për poezinë), që ky fakt gjuhësor të jetë përjashtimisht “influencë e poezisë italiane” (po aty), edhe unë kam përshtypjen që është një ekzagjerim, për shkakun e thjeshtë se pozicionime të tilla të gjinores përpara emrit në gjuhën shqipe (dhe jo vetëm në poezinë) duhet të ketë pasur edhe para periudhës së romantizmit italian dhe evropian.

Këtë e themi për faktin se: nëse është e vërtetë se është vënë në diskutim gjuha apo dialekti “barbar” i poemave të famshme të Homerit dhe se gjuha në të cilën janë të shkruara ato poema të mos jetë gjuha zyrtare greke<sup>51</sup>, apo po të doni edhe helene, atëherë është edhe e vërtetë që me trajta të këtilla të vënies përpara të gjinores, pra në fillim të vargut, poemat e famshme të Homerit janë të stërmmbushura. Në gjuhën e popullit shqiptar, gjithandej ekzistojnë shprehjet si: “I/E mjeri/a ai/ajo!” (Agimi/Luljeta), etj.

Autori dhe mësuesi Gradilone pohon me sigurinë e tij më të madhe se ky fakt gjuhësor të jetë pasojë e imitimit të vargut poetik italian apo sidoqoftë evropian, për të nxitur ndjenjën romantike apo patriotike të kombeve gjatë kësaj periudhe dhe se prej aty e këtej na është bërë traditë edhe e poezisë shqipe. E vërtetë është që poezia shqipe moderne lind relativisht vonë, por, kjo nuk do të thotë që edhe ky fenomen i gjinores të jetë domosdoshmërisht ndikim i italishtes, prandaj, besojmë

<sup>46</sup> Duhet të jetë një gabim tipografik sepse këto dy fjalë (folje+pronor) shkruhen të ndara në gjuhën italiane, pra *fosse propria*.

<sup>47</sup> (Hilmi Agani e ka nxjerrë veçmë në pah inversionin e vendit të gjinores përcaktuese, por vetëm tek Mjeda dhe te Gurakuqi, pa i zbuluar të gjitha rastet, pra pa e zhvilluar argumentin as sistematikisht, as diakronologjikisht, dhe më në fund pa e gjetë shkakun e invertimit, sikur trajta e re e sintagmës të ishte e vetja (gjuhës), pra e natyrshme e vetë gjuhës dhe jo nga modelet e marra, siç u pa, të pranishme pavetëdijshëmrisht (rezultat i përvojave letrare) apo vetëdijshëmrisht (si pasojë e një poezie apo poetike)). Përkthimin nga italishtja e kemi bërë ne.

<sup>48</sup> GIUSEPPE GRADILONE, *La letteratura albanese e il mondo classico (Quattro studi)*, Bulzoni editore, Roma 1983, f.155.

<sup>49</sup> Po aty.

<sup>50</sup> Po aty, nota 14, ff.155-156.

<sup>51</sup> Kini parasysh se sa debate shkencore ndërkombëtare dhe vepra janë bërë në lidhje me gjuhën e poemave të Homerit.

se është e natyrshme që Agani, sikurse, besoj, edhe shumica prej nesh, nuk i japim tepër rëndësi një fenomeni të këtillë të natyrshëm të gjuhës shqipe, jo për shkakun se shqiptarët të kenë nisur të shkruajnë (poezi) vetëm në shekullin e XIX dhe të kenë marrë vetëm jernekun italian, por edhe për shkakun pikërisht të vjetërsisë të vet gjuhës shqipe, që vet autori ynë në këtë libër e përshkruan dhe i krahason gjestet e shqiptarëve me vargjet e Virgjilit, Homerit, etj., për heronjtë e moçëm universalë.

Po ashtu, është e vërtetë se ky inversion që gjinorja përcaktuese t'i dalë përpara emrit, t'i japë shije dhe ndoshta edhe muzikalitet vargut, por edhe për të prodhuar rimë të caktuar në strofë, por nuk don të thotë se shqipja ta ketë imituar ndonjë gjuhë të huaj për të mësuar se si duhen shkruar poezitë. Për këtë na ka shkruar edhe studiuesi ynë i njohur në gjithë hapësirat shqiptare Shaban Demiraj: *“Ajo është pasojë e prirjes së hershme të kësaj gjuhe: Pra, [...] prapavendosja e mbiemrave, e rreshtorëve e pronorëve dhe e rasës gjinore në gjuhën shqipe nuk është një rastësi. Ajo është pasojë e prirjes së hershme të kësaj gjuhe për të vendosur rregullisht pas emrit të gjithë përcaktorët funksionalisht të pavetëmjaftueshëm”*<sup>52</sup>.

Për çka nuk kuptohet përse, nëse të jetë përdorur në prozën shqipe, pse të mos qenka pronë apo traditë edhe për poezinë? Për më tepër, shqipja është një gjuhë fleksive dhe nuk ka vështirësi dhe as dëm nga këso ‘ekzibicionizmash’ në radhitje, por edhe për faktin se nuk është tërësisht dhe përjashtimisht vetëm gjuhë SVO (subject-verb-object) dhe as SOV<sup>53</sup> (subject-object-verb). Prapëseprapë, duhet të pranojmë se poezia apo poetika shqipe edhe mund të ketë pasur ndikim nga italishtja apo edhe nga gjuhë tjera, në aspektin metrik të strofës e të formulimit të vargjeve poetike me rimat AB-AB, ose AA-BB, ose AAAB, ose ABBA, sepse shqipja është gjithnjë e gatshme të gëlltit edhe trajta dhe elemente të gjuhëve të tjera pa e dëmtuar fare as ‘fizionominë’ dhe as ‘substancën’ e vet, mu për faktin sepse është protolingua e të gjitha gjuhëve dhe këto çështje mund të konsiderohen vetëm si një akt ‘fiskulture’ për shëndetin e saj. Këtu edhe vlen ta kujtojmë pak gjëegjëzën: Kush ka ekzistuar e para: veza apo pula?!

Natyrisht, se duke qenë dhe vepruar në një vend të huaj edhe një autor apo studiues duhet që t’u përshtatet kushteve dhe ambientit ku jeton dhe punon, për më tepër shkaqe, por në shkencë nuk ka lëshime. Sidoqoftë puna e profesorit Gradilone është mjaft e vyeshme dhe një shembull *par excellence* që duhet ta marrim dhe ta praktikojmë nëse synojmë të kryejmë hulumtime të vërteta shkencore. Janë situatat e caktuara historiko-politike dhe kulturore që e përcaktojnë marrjen e një qëndrimi apo të një tjetri për secilin veprues shkencor. Në qoftë se në veprën në fjalë ka të bëhet me krahasimet e filologjisë klasike me letërsinë shqipe, besojmë se edhe qëllimi i autorit duhet të ketë qenë pikërisht dokumentimi dhe afirmimi i moçëm i gjuhës shqipe.

Dhe le të mos mendojmë se ç’ka qenë për të punuar në këtë drejtim edhe duhet doemos të mjaftojë, sepse pikërisht me ndryshimin e rrethanave politike, shoqërore, ekonomike, sociale dhe kulturore ndryshon domosdoshmërisht edhe këndvështrimi i njeriut në një realitet të ri, prandaj ky hap me kohën nuk duhet assesi të mungojë, sepse ndryshe do të krijohet një boshllëk dhe mangësi që pastaj do të mund të rezultojë, ndoshta, edhe tepër e vështirë që të recuperohet ndonjëherë më.

Studime të ngjashme janë bërë edhe nga autorë të hapësirave shqiptare si Eqrem Çabej, Shaban Demiraj, Mahmud Hysa, Gjovalin Shkurtaj, Jorgo Gjinari, Musa Ahmeti e Etleva Lala, etj., etj. Në këtë kategori të studimeve, për mendimin tim, mund të bëjnë pjesë edhe veprat e studiuesit arvanitas Niko Stylos, meqenëse ky autor konsiderohet si një ‘intruso’, megjithatë ka ca elemente të gjuhës arvanitase që, ndoshta, do të meritonin të merren parasysh, duke pa se i njëjti i

<sup>52</sup> SHABAN DEMIRAJ, Rreth vendit të përcaktorëve në gjuhën shqipe, *Studime filologjike*, Tiranë 1981, f.80.

<sup>53</sup> Ilustrim i nevojshëm këtu: me anglishten SVO por jo vetëm, edhe në italishten, etj., kemi Soggetto-Verbo-Oggetto, nënkuptojmë radhitjen e fjalisë në formatin Kryefjalë-Folje-Kallëzues, kurse me SOV, Kryefjalë-Kallëzues-Folje.

përket atij brumi të gjuhës dhe e njeh njëherit shumë mirë edhe gjuhën greke edhe ate neogreke. Por, le të kuptohemi mirë: nuk kemi për qëllim që këtë të fundit ta vëmë në të njëjtin nivel të studiuesve të kalibrit të mësipërm!

Duke konsideruar që studime të lidhura me këtë fenomen të gjuhës shqipe jemi duke i trajtuar më gjerësisht në një punim të veçantë për këtë fushë dhe me shembuj të vjelur nga prodhimtaria materiale e shkruar nga autorë të letërsisë panshqiptare, këtu do të kufizohemi vetëm të cekim se për çka, në fakt, e kemi fjalën. Në të folmet e shqipes gjithandej e kemi të pranishme trajtën e prapavendosjes në gjinoren të përcaktorëve. Pra: E lumja nëna...: E mjera...: I lumi Zot...: I mjeri trumcak...: I ngrati prind..., etj. etj., dhe këto janë shprehje të zakonshme të masës së popullit, jo për të zbukuruar apo formuluar vargje me rimë! Për çka, të thuhet se është një imitim apo huazim nga prodhimtaria romantike evropiane, do të ishte me të vërtetë paksa ekzagjeruese.

E kemi mbajtur mirë parasysh faktin që këtu kemi parashtruar materiale që janë më të vjetra se pesë vite, por, më është dukur si një shprehje që duhet rekuperuar pasi që shkallët për t'u ngjitur, nga njëherë, duhet t'i bëjmë edhe në këmbë dhe jo vetëm dhe përjashtimisht përmes ashensorit!

## References

- [1]. A&J. Picard, *Manuel de phonétique générale*, Paris 1974. Kopja në italishte e përkthyer nga Luigia Savoia e Marisa Zucchini Scalisse, Mulino, Milano 1994.
- [2]. AA.VV. Historia e letërsisë shqiptare, Rilindja, Prishtinë 1989, e redaktuar nga Dhimitër S. Shuteriqi.
- [3]. AA.VV. *Illyricum Sacrum 10*, Burime dhe dokumenta, OMBRA GVG, Tiranë 2007.
- [4]. AA.VV. *Miscellanea di albanistica*, Istituto di studi albanesi dell'Università degli studi di Roma «La Sapienza», Roma 1997.
- [5]. ALI ALIU, *Antologji e poezisë shqipe, gjysëmshkulli i artë*, Albin, Tiranë 2002.
- [6]. ELIO MIRACCO, *L'ottonario nei Canti di Milosao* di Girolamo De Rada, Cosenza 1984.
- [7]. ELIO MIRACCO, *Osservazioni sulle parlate delle comunità albanesi della provincia di Catanzaro*, Cosenza 1984.
- [8]. FRANÇESKO ALTIMARI, *Vëzhgime gjuhësore dhe letrare arbëreshe*, Shpresa & Faik Konica, Prishtinë 2002.
- [9]. GIUSEPPE GRADILONE, *Altri studi di letteratura albanese*, Bulzoni editore, pubblicati dall' Istituto di studi albanesi dell'Università di Roma, sotto la direzione del Prof. Koliqi, nuova serie Vol.VI.
- [10]. GIUSEPPE GRADILONE, *La letteratura albanese e il mondo classico (Quattro studi)*, Bulzoni editore, Romë 1983.
- [11]. MAHMUD HYSA, *Autorë dhe tekste nga letërsia e vjetër shqiptare I*, Flaka e vëllazërimit, Shkup 1992.
- [12]. SHABAN DEMIRAJ, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Mihal Duri, Tiranë 1988.
- [13]. STANISLAO MARCHIANÒ, *Pochi nomi proprii del dialetto napoletano*, (Fjalor krahasues shumëgjuhësh), Napoli 1882.
- [14]. STANISLAO MARCHIANÒ, *Studi filologici svolti con la lingua pelasgo'albanese*, Napoli 1882.
- [15]. YMER ÇIRAKU, MAKSIM GJINAJ, *Letërsia shqiptare, autorë dhe vepra*, SHBLU, Tiranë 2001.